



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:095964

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186273

KPPP.nr. 575/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Agrovita” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 810733304 dhe seli në Rahovec, rr. “Xhelel Hajdani”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Asman Hoxha, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810799504 dhe seli në Prishtinë, rr. “Ahmet Koronica”, BI-C16, Hy. 1A-Lok.3-4., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 238/24 i datës 01.03.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani nga Prizreni, jashtë seancës me datën 20.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 238/24 i datës 01.03.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 104.00 (njëqind e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Agrovita” Sh.P.K., me datë 01.03.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 238/24, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit, Faturë nr. 0000193, e datës 10.10.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 6.850.00 EUR (gjashtëmijë e tetëqind e pesëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8

% nga data e afatit për pagesë 07.02.2024 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përbarimor, me arsyetimin se urdhri përbarimor nuk përmban dokumentin e besueshëm në bazë të cilit urdhërohet përbarimi, pasi që ka pranuar vetëm propozimin për përbarim dhe jo faturat të cilat përshkruhen në propozimin për përbarim, andaj edhe urdhri përbarimor nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 43, par. 2 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të pranojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të shfuqizohet.

Kreditore, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se nuk i ka mbështetur me prova sipas nenit 69, par. 4 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura i është bashkëngjitur propozimit për përbarim dhe përmban të gjitha elementet për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të LPP-së, pasi e njëjta është në origjinal dhe e nënshkruar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak të si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 0000193 e datës 10.10.2023, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditore dhe

debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësim, gjykata gjeti se nuk është ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69 par.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve taksative të parapara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, andaj lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër të përgjigjes në prapësim të ushtruar në vlerë prej EUR 104.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve, lidhur me parashtresat për përmbarimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë mbi në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 575/24, datë 20.09.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.